

Programi për hotele dhe restorane

A dëshiron të punosh me shërbime?

A dëshiron të nisësh sipërmarrjen tënde në ardhmëri?

A dëshiron të keshë mundësi të kërkosh punë menjëherë pas gjimnazit?

A dëshiron të punosh ose të studijosh jashtë vendit?

A dëshiron të punosh së bashku me të tjerët, si specialist i lëmisë tënde?

Në atë rast, Programi për hotele dhe restorane mund të jetë për ty.

Te Programi për hotele dhe restorane do të mësosh dituri për shërbime, përgjegjësi, administrim dhe ekonomi që do të nevojiten me qëllim që të nisësh sipërmarrjen tënde ose që të punosh me shërbime në një lëmi që të intereson ty. Do të mendosh për shumë çështje aktuale, si për shembull ekologji dhe zhvillim të qëndrueshëm. Do të mësosh se si të bashkëpunosh me të tjerët.

Lëmia e hoteleve dhe e restoraneve është ndërkombëtare. Me dituri gjuhësore dhe me kuptim e interesim për kutura të tjera, do të kesh mundësi të mira që të punosh apo studijosh jashtë vendit pas kohës në program.

Të punosh apo t'i vazhdosh studimet

Nëse zgjedh Programin për hotele dhe restorane mund të kërkosh punë menjëherë pas gjimnazit. Llojet e punëve ku mund të pranohesh varren nga drejtimi që e ke zgjedhur. Mund të zgjedhësh që të vazhdosh studimet, te Fakulteti i profesioneve por edhe te univeristet dhe fakultetet. Nëse studijon në fakultet, mund për shembull të bëhesh dietist. Pyete udhërrëfyesin tënd të studimeve dhe të profesioneve se cilat kurse gjimnaziale do të duhet që të zgjedhësh që të mundesh të aplikosh për kualifikimin që të intereson.

Punë ku mund të pranohesh

Pasi që i ke përfunduar studimet në Programin për hotele dhe restorane, mundesh për shembull të kërkosh punë si kuzhinier, kuzhinier i ushqimeve të ftohta, servitor, recepsionist ose mbajtës i konferecave.

Përmbajtja e Programit

Programi për hotele dhe restorane përbëhet prej kurseve. Disa kurse janë obligatorike për të gjithë ata që studiojnë në gjimnaz. Kurse e tjera janë veçanta për Programin për hotele dhe restorane. Disa nga kurset do të mund t'i zgjedhësh vetë.

Programi përbëhet prej dy drejtimeve ndërkombëtare. Kjo do të thotë se të gjithë ata që studiojnë në Programin për hotele dhe restorane në tërë vendin mund t'i zgjedhin drejtimit. Në disa vende mund të ketë edhe me tepër drejtime që ndoshta të përshtaten ty më së miri! Pyete udhërrëfyesin tënd të studimeve dhe të profesioneve!

Drejtimet kombëtare janë:

- Hotel – për ty që dëshiron të punosh me hotele, me aktivitete konferencash, me servime dhe me përjetime
- Restorane – dhe shërbime ushqimesh – për ty që dëshiron të punosh me përgatitje ushqimesh ose servime.

Kontakte me tregun e punës

Te Programi për hotele dhe restorane do të kesh kontakte me tregun e punës që nga koha e gjimnazit. Do të keshë të paktën 15 javë kualifikim në vende të punës (APU). APU-në tënde e planifikon shkolla në bashkëpunim me vende të lira të punës aty ku banon ti. Kjo është një mënyrë e mirë që të krijoni kontakte të cilat mund t'i përdorësh kur do të kërkosh punë. Nëse të intereson ta bësh APU-në tënd në një vend tjetër përveç Suedisë, kjo mundësi do t'ju jepet.

Ardhmëri dhe punë

Ke mundësi shumë të mira për punësim menjëherë pasi që i përfundon studimet te Programi për hotele dhe restorane, por kjo varret nga drejtimi dhe kurset që i ke zgjedhur. Mundësitë e tua rriten në rast se ke shumë përvojë praktike. Mundësia më madhe për tu punësuar është në qytetet e mëdha dhe në vendet turistike. Sasia e punëve varret poashtu edhe nga stina. Gjatë verës, festave dhe kur shkolla mbyllet ka më tepër punë.